



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, nenit 17 të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.02.2025, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS –LOKALEVE AFARISTE NË ZONAT KADASTRALE LIPJAN DHE MAGURË

Neni 1

Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës – lokaleve afariste për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme lokaleve afariste të Komunës në Zonat Kadastrale Lipjan dhe Magurë 15Nr. 463/02-9567 i datës 28.02.2025 (në vazhdim të tekstit: Komisioni në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, prej të cilëve 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga përbërja e ekzekutivit të Komunës, 2 (dy) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet politike dhe 1 (një) anëtar nga sektori jo qeveritar lokal.

2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1. Valon Pacolli nga ekzekutivi i Komunës,
2. Latif Ramadani nga ekzekutivi i Komunës,
3. Fitim Shala nga subjektet politike,
4. Lulzim Rrustemi nga subjektet politike dhe
5. Bekim Krasniqi nga sektori joqeveritar lokal

Neni 2

Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit.

Neni 3

Mandati i anëtarëve

Manadati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme - lokaleve afariste të Komunës në Zonat Kadastrale Lipjan dhe Magurë 15Nr. 463/62-9567 të datës 28.02.2025.

Neni 4

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni, për të zbatuar Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës të cekur më lartë me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nënligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës – Sektori për Çështje Pronësore-Juridike.

Neni 6

Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Njoftimi publik do të kompenzohen në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse. Kompenzimi do të bëhet vetëm për anëtarët e komisionit të cilët nuk e kanë të ndaluar kompenzimin për kryerjen e shërbimeve shtesë konform dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr. 15-463/02-9570
Lipjan, më 28.02. 2025

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

